

BULETIN INFORMATIV 2021

INFORMACION PËRMBLEDHËS I
RRJETIT POP
PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

JANAR - DHJETOR 2021



**POP - PËRBALLJA
E OFERTAVE
POLITIKE**



Bashkia Korçë



Bashkia Elbasan



Bashkia Vau i Dejës

12 KONTRATA SOCIALE

Nëpërmjet nismave dhe aktiviteteve të Rrjetit POP, një nga synimet ishte zgjerimi i rrjetit në vitin 2021 edhe në bashki të tjera dhe kjo u arrit duke shtuar bashkitë e: Elbasanit, Vaut të Dejës dhe Korçës.

Përzgjedhja e organizatave u realizua përmes një thirrjeje të hapur e cila u publikua në rrjetet sociale dhe në faqen e POP.

Organizatrat e përzgjedhura pas votimit të anëtarëve të rrjetit POP:

1. Tjetër Vizion - Elbasan
2. Hapa të Lehtë - Vau i Dejës
3. Gruaja në Zhvillim - Korçë

Gjatë pranverës, organizatat e reja të rrjetit POP realizuan fokus grupe me qytetarët e bashkive respektive duke përpiluar kështu Kontratata Sociale, të cilat u firmosën nga kryetarët e bashkive dhe u prezantuan në forumet publike mes qytetarëve dhe drejtuesve të pushtetit vendor.

Rrjeti POP zgjerohet në tre bashki të tjera!

Tashmë rrjeti POP ka 12 Kontrata Sociale si mekanizma për llogaridhënien e drejtuesve të bashkive dhe angazhimin qytetar në nivel vendor.




[Klikoni për të lexuar kontratat](#)



ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2021

Në kuadër të Zgjedhjeve Parlamentare të 25 prillit 2021, anëtarët e Rrjetit POP organizuan 7 Forume Publike me pjesëmarrjen e kandidatëve për deputetë të Parlamentit Shqiptar, nga parti të ndryshme politike.

Në këto forume u diskutua mbi platformat elektorale të secilit subjekt politik si edhe u orientuan drejt pikave të Paktit Social të vitit 2017 dhe Kontratës Sociale të vitit 2019, si prioritetet qendrore dhe lokale. Diskutimi u fokusua sipas prioritetëve të qytetareve.



Shkodër
16.4.2021

Durrës
14.4.2021


Fier
19.4.2021

Vlorë
15.4.2021

Kukës
13.4.2021

Tiranë
17.4.2021

Korçë
21.4.2021



Për shkak të masave anti-Covid, forumet publike u organizuan në format hibrid me pjesëmarrje të limituar në sallë dhe me përfshirjen e qytetarëve në platformën ZOOM dhe transmetim direkt në Facebook.

7 Forume Publike mes kandidatëve për deputetë dhe qytetarëve në 7 qarqe



Tiranë



Durrës



Vlorë



Kukës



Korçë



Fier



Shkodër

KONFERENCË KOMBËTARE

Kliko për të ndjekur konferencën



Në datë 22.6.2020 rrjeti POP organizoi Konferencën Kombëtare 'Pjesëmarrja dhe Përgjegjësia e Shoqërisë Civile në Proceset e Qeverisjes Vendore'

Gjatë kësaj konference u diskutua mbi pjesëmarrjen dhe angazhimin qytetar në nivel vendor, dhe u prezantua Raporti Studimor "Përfshirja dhe angazhimi qytetar në nivel vendor"

Raporti është prezantuar nga organizatat lokale anëtare të rrjetit në të gjitha bashkitë nga kanë dalë edhe gjetjet.



RAPORT STUDIMOR

PJESËMARRJA DHE ANGAZHIMI QYTETAR NË NIVEL VENDOR

Durrës, Elbasan, Fier, Kamëz, Korçë, Kukës, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tiranë, Vau i Dejës dhe Vlorë

Qershor 2021

Ky raport studimor analizoi dhe vlerësoi pjesëmarrjen dhe përfshirjen qytetare në qeverisjen vendore gjatë 2019-2020, e cila përkon edhe me periudhën e pandemisë Covid 19. Raporti është ndërtuar mbi gjetjet e dala nga anketimi në 12 njësi të vetëqeverisjes vendore (bashki).

Të intervistuarit janë 42 punonjës vendorë nga bashkitë Elbasan, Durrës, Fier, Kamëz, Korçë, Kukës, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tiranë, Vau i Dejës dhe Vlorë.



Kliko për të lexuar raportin

FOKUS GRUPE ME KOMUNITETIN


Në kuadër të monitorimit të bashkive në vitin e dytë për përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale, anëtarët e rrjetit POP organizuan takime periodike me qytetarët dhe përfaqësues të bashkive.

Qëllimi i këtyre takimeve ishte diskutimi me qytetarët sa i përket punës së bashkisë për përmirësimin e jetesës së tyre të përditshme si edhe lobimi pranë bashkive për transparencë dhe angazhimin qytetar në vendimmarrje.

Angazhimi i qytetarëve në nivel vendor si edhe përdorimi i mekanizmave të POP për të advokuar për prioritetet e rëndësishme të veçantë për komunitetin është edhe një prej qëllimeve kryesore të POP.



- 60 fokus grupe me komunitetin
- 100 takime me përfaqësues të bashkive
- 150 mbledhje të Këshillit Bashkiak të monitoruara



 [Kliko për tu njohur me takimet e realizuara](#)

FUSHATA ADVOKUESE



Organizatat e rrjetit POP organizuan 12 fushata advokuese në bashkëpunim me qytetarët për përmbushjen e prioriteteve të përzgjedhura nga komuniteti, si pjesë e mekanizmit të Kontratës Sociale POP.

Fushatat e advokimit përfshinë: Nënshkrimin e peticioneve nga qytetarët; takime mes komunitetit dhe administratës së bashkisë; takime me anëtarë të Këshillit Bashkiak; prezencë në media; lobim gjatë procesit të buxhetimit vjetor etj.


12 fushata advokuese u realizuan me qytetarët dhe 4 çështje morën dritën jeshile në buxhetin e vitit 2022

Vlorë

Prioritet i Kontratës Sociale

Investimet në rrugën lidhëse mes fshatrave Kërkovë dhe Bestrovë.

Në dhjetor 2021, ky prioritet është buxhetuar për t'u realizuar gjatë vitit 2022.




Korçë

Prioritet i Kontratës Sociale

Ndërhyrje për rikonstruktionin e shkollës "Sotir Beçka" në Bulgarec.

Prioriteti është përfshirë në linjën buxhetore të buxhetit për mirëmbajtjen e shkollave dhe pritjet që ndërhyrjet të kryhen në maj 2022.



Vau i Dejës

Prioritet i Kontratës Sociale

Ngritja e një çerdhe/kopshti me drekë në këtë bashki.

Më mbledhjen e Këshillit bashkiak të Vaut të Dejës më 23 dhjetor 2021, bashkia miratoi një fond prej 3 000 000 lekësh për ngritjen e një qendre komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe përshtatjen e një godine për çerdhe/ kopësht me drekë.



Kukës + Fier

Prioritet i Kontratës Sociale

Ngritja e Këshillit Rinor Vendor

Në 2021 është miratuar ngritja e Këshillit Vendor Rinor. Në Kukës ky këshill është konsoliduar. Fier: Vijon lobimi për konsolidimin brenda muajit mars 2022.





RAPORTET MONITORUESE VITI II-TË

Bazuar në monitorimin e punës së bashkive në periudhën shtator 2020 – shtator 2021, monitorimin e vendimeve të Këshillave Bashkiakë, fushatave advokuese, takimeve me qytetarët, anëtarët e rrjetit POP publikuan Raportin e dytë monitorues të Kontratës Sociale. Raportet janë individuale dhe pas publikimit të tyre u prezantuan pranë bashkive si edhe në takime me qytetarë dhe organizata të shoqërisë civile.



Tiranë



Fier



Durrës



Korçë

12 Raporte individuale monitoruese të përmbushjes së prioriteteve të Kontratës Sociale.



Pogradec



Kamëz



Vlorë



Pukë



Kukës



V.Dejës



Elbasan



Shkodër



1. **Bashkia Durrës:** Përmirësimi i infrastrukturës shkollore.
2. **Bashkia Elbasan:** Shtimi i frekuencës së pastrimit të qytetit dhe pajisja me kazanë të rinj për mbetjet.
3. **Bashkia Fier:** Qendra e aktiviteteve kulturore për të rinjtë dhe fëmijët ka rinisur funksionalitetin.
4. **Bashkia Kamëz:** Investime në 5 kopshte duke rritur kapacitetet për të akomoduar më shumë fëmijë.
5. **Bashkia Korçë:** Miratuar në paketen e re fiskale për vitin 2022 përjashtimin nga taksat për bizneset e ngritura nga të rinjtë për vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit të tyre.
6. **Bashkia Kukës:** Ngritja e Këshillit Vendor Rinor dhe instituzionalizimi i tij.
7. **Bashkia Pogradec:** Buxhetuar fondi i posaçëm për mbështetjen e të rinjve dhe projekteve rinore.
8. **Bashkia Puke:** Ndërtimi i Qendrës Sportive për të rinjtë dhe komunitetin.
9. **Bashkia Shkodër:** Rritje të transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare në nivel vendor.
10. **Bashkia Tiranë:** Shtimi i shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës në familje.
11. **Bashkia Vau i Dejës:** Rikonstruktimi i banesave dhe pagesa e qerasë për grupet në nevojë.
12. **Bashkia Vlorë:** Ndërtimi i mekanizmave të unifikuar dhe efektiv (Buxhetimi me Pjesmarrje) për të marrë këndvështrimin e komunitetit mbi vendimarrjet e pushtetit vendor.

ADRESIMI I PRIORITETEVE TË KONTRATËS SOCIALE

Sipas bashkive nën monitorim
Viti i dytë i monitorimit.

Bashkitë Elbasan, Vau i Dejës dhe
Korçë, viti i parë i monitorimit

80%

e prioriteteve të bashkisë
Tiranë janë adresuar pjesërisht
apo plotësisht

40%


e prioriteteve të bashkisë
Elbasan janë adresuar brenda
vitit të parë të monitorimit

PËRQINDJA SIPAS BASHKIVE

Adresimi i prioriteteve të qytetarëve
nga pushteti vendor gjatë dy viteve të
implementimit të Kontratës Sociale.

PËRMBUSHJA E PRIORITETEVE SIPAS BASHKIVE

Përqindja e zbatimit të Kontratës Sociale sipas bashkive



KONFERENCË KOMBËTARE

Nxitja e Integritetit në Nivel Lokal në Shqipëri

JAVA E
INTEGRITETIT

JAVA E INTEGRITETIT

Kliko për të ndjekur
konferencën



Në dhjetor, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim në partneritet me anëtarët e Rrjetit Përballja e Ofertave Politike POP organizuan Konferencën Kombëtare "Nxitja e Integritetit në Nivel Lokal në Shqipëri"

Qëllimi i kësaj konferencë ishte diskutimi me përfaqësues të pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe medias mbi rëndësinë e integritetit në lidhshmëri për të rritur besimin e publikut. Gjatë konferencës u ndanë me pjesëmarrësit dhe publikun përvoja të mira bashkëpunimi dhe metodologji të rrjetit POP dhe përfaqësuesve të pushtetit lokal.

7 video u realizuan me drejtues të bashkive mbi angazhimin e tyre për përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale.



Tiranë



Vlorë



Shkodër



Pukë



Kukës



Fier



Pogradec



